

Fëmija im do të fillojë shkollën së shpejti



Disa mendime për
lehtësimin e fillimit
të vitit të parë
të shkollës

Duke pritur fillimin e vitit të ri shkollor, ju duhet ta nxisni fëmijën tuaj që:



të shkojë në banjë
dhe të lajë duart,
pa ndihmën
e të tjerëve



të zhvishet e vishet vet



të veshë xhaketën
e ta mbyllë atë



të veshë këpucët



të vërë në
rregull gjërat e tij



të shfryjë hundët



Ta nxisni fëmijën tuaj dhe
ta përgëzoni atë, sa herë
që ai mundohet ta bëjë
vet një gjë të tillë!

Kur doni të dini se si e ka kaluar ditën në shkollë, bëjini pyetje me qëllim që ta nxisni të flasë:

- Ke bërë ndonjë vizatim sot?
- A e hëngre ushqimin gjatë pushimit?
- Me kë luajte?
- Ndodhi ndonjë gjë e veçantë?
- Çfarë mësove sot?
- Çfarë të pëlqeu më shumë nga ato që bëre sot në shkollë?
- ...

Loja është veprimtaria më e rëndësishme e fëmijëve. Në fakt, loja ua lehtëson atyre përvetësimin e mësimave.



«Loja, është puna e fëmijës, është profesioni i tij, është jeta e tij.»

Pauline Kergomard, themeluese e shkollave foshnjore në Francë

Loja mundëson gjithashtu hyrjen në kontakt me të tjerët, respektimin e tyre, ndarjen e krijimit e lidhjeve me ta.



DEF Département de l'enseignement et de la formation professionnelle
DGEO Direction générale de l'enseignement obligatoire et de la pédagogie spécialisée

www.vd.ch/scolarité
Illustrime : Jean Augagneur, Lausanne
Grafika : Yves Gablroud, Puidoux